



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Administratës
Periudha raportuese	Gusht, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Vasilika Zotaj

1. PËRMBLEDHJE

Sektorët me përpikëri kanë realizuar detyrat e parashtruara dhe të kërkuara nga ta. Është vërejtur fluks i madhe i qytetarëve në sektorët e Zyrës së gjendjes civile . Për shkak të pandemisë Coronavirus, COVID -19, kemi pasur shumë ngarkesë, për shkak se stafi është reduktuar në tërë Institucionet e Republikës së Kosovës.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Drejtoria e Administratës është duke realizuar edhe një numër të projekteve tjera, të cilat nuk janë paraparë me Planin e veprimit në fillim të vitit, por të cilat projekte dalin si nevojë në përkrahje të avancimit të shërbimeve ndaj qytetarëve. Të gjitha këto projekte do të listohen gjatë muajve të ardhshëm në këtë raportim.

2. STATISTIKAT SEKTORIALE

	Drejtoria	Të pranuar	Në Proces	Të miratuar	Të refuzuar	Të pezulluar	Të anuluar	Të përfunduar	Gjithsej
1	Drejtoria e Administratës	6	169	508	0	0	0	9,026	9.709
2	Drejtoria e Shëndetësisë	0	36	1	0	0	0	0	37
3	Drejtoria e Arsimit	0	79	0	0	8	0	0	87
4	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm	0	54	22	0	0	1	0	77
5	Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	0	160	7	1	0	1	0	169
6	Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave	2	100	0	0	0	0	0	102
7	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit	0	313	6	0	0	0	0	319
8	Drejtoria e Kulturës	0	5	1	0	0	0	0	6
9	Drejtoria e Inspeksionit	0	166	51	0	0	0	0	217
10	Drejtoria e Financave	90	469	10,368	0	0	15	0	10,942
11	Drejtoria e Kadastrit	6	1,261	917	0	0	23	0	2,207
12	Drejtoria e Bujqësisë	0	78	0	1	0	3	0	84
13	Kabineti i Kryetarit	6	308	52	0	0	0	0	366
14	Drejtoria e Pronës	0	20	2	0	0	0	0	22
15	Drejtoria e Mirëqenies Sociale	0	26	5	0	1	0	0	32
16	Drejtoria e Sportit	0	2	0	0	0	0	0	2

1		0	6	1	0	0	0	0	7
7	Drejtoria e Parqeve								
		110	3,252	11,941	2	9	43	9,026	24,385

3. GJENDJA CIVILE

Udhëheqës i Gjendjes Civile, Fehmi Kupina

1	Ekstrakte të lindjes	11,427
2	Certifikata të lindjes	8,429
3	Certifikata të martesës	1,127
4	Certifikata të vdekjes	882
5	Certifikata të vendbanimit	205
6	Certifikata të shtetësisë	233
7	Certifikata të bashkësisë familjare	1,024
8	Vërtetim nga Arkivi	0
9	Status martesor	466
10	Certifikata e statusit martesor	507
11	Deklaratë e bashkësisë familjare	1,024
	Gjithsej	23,834

4. SEKTORI I TI

Udhëheqës i Sektorit të TI, Hysen Hyseni

Gjatë muajit gusht 2020, Sektori për teknologji informative, ka ofruar shërbimet si në vijim:

- Kemi kryer shërbime softuerike dhe harduerike, për administratën komunale dhe institucioneve tjera komunale:
 - instalimi dhe konfigurimi i sistemeve operative, programeve aplikative,
 - instalimi dhe konfigurimi i serverëve,
 - instalimi dhe konfigurimi i kompjuterëve për operim funksional në rrjetë,
 - instalimi dhe konfigurimi i printerëve, fotokopjeve, ploterëve, digjital senderëve etj.,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemit të sistemit operativ dhe programeve aplikative,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemeve harduerike,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në rrjetin lokal (LAN);

- Jemi kujdesur për siguri në teknologji informative, në rrjeta, aparate, sisteme dhe programe, të cilat punojnë dhe ruajnë të dhëna të ndjeshme. Kemi bërë kopjet (backup) ruajtjen e të dhënave të rëndësishme nga bazat e të dhënave të ndryshme që kemi në Komunë,

- Kemi mirëmbajtur serverët e Komunës së Prishtinës;

- Kemi bërë mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrjetit LAN dhe, sipas nevojës, kemi bërë kyçjen e kabllove në kabinete, switch-a, dhe përcaktimi i porteve;

- Kemi vazhduar krijimin e llogarive në e-mail-in zyrtar për stafin e Komunës, në bashkëpunim me MAP/Agjencinë për Shoqëri të Informacionit (ASHI);

- Kemi mirëmbajtur e-kiosqet e Komunës së Prishtinës;

- Kemi mirëmbajtur sistemin e menaxhimit të radhës;

- Kemi bërë monitorimin e mbledhjeve të KK-së së Prishtinës përmes teleprezencës;

- Kemi azhurnuar informatat në aplikacionin e-Shpenzimet;

- Përditësimi i informatave në ueb-faqen zyrtare dhe “Prishtina Online”;

Kemi menaxhuar dhe mbikëqyrë këtë projekte:

- Platforma për hapjen e të dhënave “Prishtina Open Data”;
- Kemi menaxhuar dhe mirëmbajtur Platformën Digjitale për Partecipim Publik;
- Menaxhim i Data-bazës së klientëve për projektin e shërbimeve publike “Menaxhimi i mbeturinave”.

Kemi menaxhuar dhe mbikëqyrë këto kontrata:

- Kontratën e AQP-së “Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira”;
 - Furnizimi me pajisje të TI-së, për nevojat e Komunës;
 - Furnizimi me tonerë për nevojat e Komunës së Prishtinës;
 - Mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit elektronik të automjeteve me pajisje GPS,
- Vendosja e e-kiosqeve, nëpër BL, montimi, konfigurimi i tyre.

5. SEKTORI I LOGJISTIKËS

Udhëheqës i Sektorit, Rifat Gashi

Sektori teknik ka zhvilluar aktivitetin e tij në mbështetje të Planit vjetor të punës, në mbështetje të Rregullores mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Gjatë kësaj periudhe është bërë:

- Sigurimi i objekteve të Komunës;
- Mirëmbajtja e ndërtesave të Komunës;

- Mirëmbajtja e higjienës në objektet e Komunës;
- Shërbimet hoteliere nga bufeja e Komunës për zyrtarët e Komunës;
- Mirëmbajtja e ashensorëve në objektin e ri-vjetër të Komunës;
- Organizimi dhe menaxhimi i shfrytëzimit të automjeteve zyrtare;
- Byroteknika ka bërë fotokopje, 10940 copë.

6. SEKTORI I BASHKËSIVE LOKALE

Udhëheqës i Sektorit të Bashkësive Lokale, Fadil Leci

Gjatë periudhës raportuese, në cilësinë e udhëheqësit të Sektorit kam kryer këto punë:

Është punuar në komisionin për përzgjedhjen e shefit të Sektorit të Drejtorisë së Pronës;

Në cilësinë e menaxherit, kam bërë monitorimin e realizimit të kontratës për pastrimin e objekteve komunale;

Kam bashkëpunuar me Drejtorin e Infrastrukturës dhe Urbanizmit, për dhënien e lejes për ndërtimin e objektit të BL-së në Marec;

Kam pritë dhe udhëzuar shumë palë për realizimin e kërkesave të tyre, si dhe kam bërë dezinfektimin e BL-së në “Mëhallën e Muhaxhirëve”.

Takimet me institucione të tjera

- Vizitë BL-ve dhe ofiqarive në qytet dhe fshatra, mbledhja e informacioneve dhe njohja nga afër me problemet që mund t'i shoqërojnë funksionimin normal të bashkësive lokale dhe ofiqarive.

Lëndët e pranuarra, të kryera dhe në përfundim e sipër:

- Të gjitha lëndët e pranuarra janë shqyrtuar, por një pjesë e tyre është në proces (kërkesat për punë praktike – mbledhen dhe pastaj intervistohen të gjithë aplikuesit që kanë parashtruar kërkesë; kërkesat për kompensime nga dëmet e shkaktuara të natyrave të ndryshme). Të gjitha të tjerat janë të përfunduara, siç edhe shihet në tabelën e raportimit të sektorit të Qendrës së Shërbimit për Qytetarë.

Takime të tjera

- Takime të rregullta me udhëheqësit e sektorëve në kuadër të Drejtorisë së Administratës.

SFIDAT

- Kemi pasur sfida në pajisjen e punëtorëve, si dhe qytetarëve me pajisje mbrojtëse, si doreza, maska dhe dezinfektues në mbrojtje nga pandemia Coronavirus - COVID 19;
- Sfide ka qenë edhe mbajtja e rendit, për shkak të fluksit të madh të qytetarëve dhe reduktimit të stafit për shkak të pandemisë.

REKOMANDIME

- Të kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme mbarëvajtja e punëtorëve të Komunës;
- Të kontrollohen punëtorët për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, si doreza, maska, dezinfektues dhe distanca;
- Të kontrollohen palët për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, si doreza, maska dhe dezinfektues, nëse jo, të ju sigurohen.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Pajisja në vazhdimësi e objekteve të bashkësive lokale me kompjuterë dhe printerë, atje ku mungojnë. Në momentin e lirimt të fluksit të punës së Hortikulturës, kemi marrë aprovimin se do të na mbështesin për gjelbërimin e territorit përpara bashkësive lokale.

7. RAPORTI I KOMISIONIT PËR ANKESA

Në bazë të vendimit për hapjen e kutive të ankesave, komisioni hapi kutitë e ankesave, më 02.09.2020, sipas planprogramit dhe i shqyrtoi, duke i ndarë nëpër objekte, si në tabelën në vazhdim.

Nr.	Drejtoria	Numri i ankesave
1.	Objekti i ri i Komunës	8
2.	Objekti i vjetër i Komunës	1
GJITHSEJ		9

Komisioni: Nefi Krasniqi, Fehmi Kupina, Fadil Leci

8. SHËRBIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Punonjësit dhe detyrat e punonjësve të Shërbimit të Kuvendit.

1. Luljeta Selimi, u.d. e udhëheqëses së Sektorin e Kuvendit.

Punët dhe detyrat e udhëheqësit të Sektorit të Kuvendit, kryesisht ndërlidhen me organizimin dhe koordinimin e punëve brenda sektorit, si për ndarjen e punëve dhe në kujdesin për angazhimin e plotë të punëtorëve që këto punë të kryhen në mënyrë më të rregullt.

Gjatë muajit gusht është punuar kryesisht rreth organizimit dhe përgatitjes së materialeve për mbledhjen e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Gjithashtu, është punuar rreth organizimit dhe përgatitjes së mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Janë punuar edhe punë të tjera, të cilat ndërlidhen me natyrën e këtij sektori.

2. Zijadin Gashi, zyrtar i lartë për punë profesionale të Kuvendit të Komunës, ka kryer këto punë:

Ka marrë pjesë në përgatitjen e materialit për mbledhjen e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të mbledhjes së katërt të Kuvendit.

Ka marrë pjesë në dëgjimet publike buxhetore që janë mbajtur në distancë, në formën online, përmes ZOOM-it.

Ka kryer edhe punë të tjera sipas kërkesës së u.d. të shefit të Sektorit të Kuvendit.

3. Shyhrete Islami, zyrtare e lartë për punë profesionale të Kuvendit komunal, ka kryer këto punë:

Ka marrë pjesë në mbledhjen e katërt të Komitetit për Politikë e Financa.

Ka përgatitur ekstraktin e mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë e Financa.

Ka ndihmuar në përpilimin e transkriptit të mbledhjes së katërt të Kuvendit.
--

Ka kryer edhe punë të tjera sipas kërkesës së u.d. të shefit të Sektorit.

4. Shefki Jashari, zyrtar për lekturim, ka kryer këto punë:

Emërtimi i dokumentit	Faqe	Dt. e dorëz.
Propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të “Sima Com” dhe Adnan (Ali) Memedaliut.	2 f.	4.8.2020
Propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Meliha Rrmokut.	2 f	4.8.2020

Rregullore për definimin e parametrave urban - arkitektonik të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese	4 f.	4.8.2020
Vendimi për Planin komunal të veprimit për efikasitet të energjisë (PKVEE) 2019 – 2021.	2 f.	4.8.2020
Ekstrakti i mbledhjes së tretë të Kuvendit	9 f.	5.8.2020
Protokoll për hapjen e kopshteve në komunën e Prishtinës	6 f.	5.8.2020
Deklaratë mbi të drejtat dhe detyrimet e prindit për vendosjen e fëmijës në çerdhe, referuar dokumenteve të parapara për këtë çështje, për masat mbrojtëse dhe parandaluese ndaj Covid -19, të ndërmarra nga institucionet përkatëse.	1 f.	5.8.2020
Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, 01. nr. 110-21449, i dt. 28.02.2013	2 f.	10.8.2020
Transkripti i mbledhjes së tretë të Kuvendit	54 f.	14.8.2020
Ekstrakti i mbledhjes së katërt të KPF-së	6 f.	17.8.2020
Raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë, korrik 2020	9 f.	17.8.2020
Raporti i Drejtorisë së Kulturës, korrik 2020	10 f.	18.8.2020
Raporti i Drejtorisë së Inspeksionit, korrik 2020	8 f.	18.8.2020
Raporti i Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, korrik 2020	6 f.	19.8.2020
Protokoll për hapjen e shkollave të komunës së Prishtinës, për vitin shkollor 2020/2021	7	21.8.2020
Informues për lehtësimin e pagesës së tatimit në pronë	8	21.8.2020
Raporti i Drejtorisë së Kadastrit, korrik 2020	8	25.8.2020
Vendim për vendosjen e një çezme në sheshin “Zahir Pajaziti”	1	27.8.2020
Raporti i DIKMK, korrik 2020	82	27.8.2020
Raporti i Drejtorisë së Arsimit, korrik 2020	13	28.8.2020
Raporti i Drejtorisë së Urbanizmit, korrik 2020	12	28.8.2020

5. Miranda Pacolli - Dibra, zyrtare për përkthim, shqip- serbisht, ka kryer këto punë:

Inspektorët e ndërtimit		03.08.2020
Vazhdojnë punimet te rruga “Andrea Gropa”		03.08.2020
Asfaltimi i rrugës “Fehmi Lladrovci”		03.08.2020
Asfaltimi i rrugës “Gazmend Zajmi”		
Faza e pestë e dezinfektimit		10.08.2020
Dezinfektohen kopshtet publike		10.08.2020
Fondacioni “Sunny Hill”		
Drejtoresha e kulturës, Blerta Basholli		10.08.2020
Drejtoresha, Shpresa Shala		11.08.2020
Suspendimi i kushtëzimit të pagesës së tatimit në pronë		13.08.2020
Rrënohet objekti pa leje		13.08.2020
2. Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa		14.08.2020
6.1 Vendim për këmbim, “Sima Com” dhe Adnan (Ali) Memedali		14.08.2020
7.1 Propozimvendimi për këmbim, Meliha Rrmoku		14.08.2020
8.1 Propozimvendim për këmbim -Ismail Shillova, Faik Breznica dhe Osman Breznica		14.08.2020
10.2 Propozimvendimi për planin komunal të veprimit për efikasitet të energjisë (PKVEE) 2019-2021		14.08.2020
Vendim për konsulta paraprake		14.08.2020
Orari i dëgjimeve publike		16.08.2020
Vazhdojmë me vendimet mbi rrënimet		18.08.2020
Kopshti me bazë në komunitet “Botanika”		18.08.2020
Të mërkurën, rruga “Agim Ramadani” mbyllet për qarkullim		18.08.2020
Rrënohet konstruksioni metalik		18.08.2020
Drejtori i shëndetësisë, Bujar Gashi		19.08.2020

Vazhdojnë punimet në rregullim të parkingut		19.08.2020
Nënkryetari, Muhadin Nushi, dhe drejtoresha për Arsim		19.08.2020
Po asfaltohet aksi i rrugës “Agim Ramadani”		19.08.2020
Orari i Tregut mobil		20.08.2020
Drejtori, Dren Kukaj, viziton punimet		21.08.2020
Drejtoresha, Medina Braha		25.08.2020
Drejtori, Gëzim Mehmeti		25.08.2020
Drejtorja e Bujqësisë ndau subvencione		25.08.2020
Kryetari, Shpend Ahmeti, së bashku me homologët nga komunat		25.08.2020
Kryetari, Shpend Ahmeti, nënshkroi Marrëveshje të mirëkuptimit		26.08.2020
Nesër, në orën 19:30		26.08.2020
Kryetari, Shpend Ahmeti, bashkë me drejtoreshën për Arsim, Shpresa Shala.		27.08.2020
Drejtoresha e Shërbimeve Publike, Medina Braha.		27.08.2020
Ekrane digjitale me orar të saktë të qarkullimit të autobusëve		28.08.2020
Direktorka obrazovanja, Shpresa Shala, posetila je školu "Ismail Qemali"		28.08.2020
Edicioni i katërt “Meeting of Styles”		31.08.2020
Konkurse ndërkombëtare arkitektonike		31.08.2020
Art në hapësirat publike		31.08.2020
Rivitalizimi i hapësirave të gjelbra		31.08.2020

6. Lendita Spahija, zyrtare për mbështetje administrative teknike të Kuvendit komunal, ka kryer këto punë:

Ka marrë pjesë në përgatitjen e materialit për mbledhjen e katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës
Ka marrë pjesë në mbledhjen e katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, më 10.08.2020

Ka marrë pjesë në vazhdimin e mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës, më 12.08.2020

Ka përgatitur transkriptin e mbledhjes së katërt të Kuvendit.

7. Albina Behluli, zyrtare për përkthim, shqip- serbisht.

8. Arton Brahimi, zyrtar për arkiv 1.